

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Menaxhimi i Performancës

P8

Nr.

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data Date

21.10.2021

Problemi 1

Kompania 'LUX' bërë prodhimin e aksesorëve të lëkurës për shtëpitë e njohura të modës, produkte të cilat i përdorin manekinet në shfaqjet e modës. Produkti më i kërkuar i kompanisë është rripi i prodhuar nga lëkura kualitative e importuar nga Amerika Jugore.

Produktet janë punë-dore që punohen nga mjeshtër të shkathtë me përvojë. Një rrip prodhohet për 60 minuta dhe nevojiten 0.2m² lëkurë. Norma e punës së mjeshtrit është €24.00 për orë, ndërsa çmimi i blerjes së lëkurës është €80.00 për m². Kostot tjera të prodhimit janë ShPP variabile prej €6.00 për rrip dhe ShPP fikse në vlerë prej €40,000. Çmimi i shitjes është €96.00 për rrip.

Për 'Javën e modës' ngjarjen më të madhe të modës të organizuar kohëve të fundit, organizatori ka kontraktuar nga kompania 'LUX' 250 çanta dore të cilat do të përdorën nga manekinet gjatë paraqitjes në skenë. Në rast të mos-dorëzimit me kohë të çantave sipas kontratës parashihet pagesa e gjobës financiare nga ana e kompanisë 'LUX'. Për prodhimin e një çante të dorës, kompania përdorë 1.5m² të lëkurës, ndërsa koha e nevojshme e prodhimit është 2 orë të punës direkte. ShPP variabile për prodhimin e një çante është €20.00 ndërsa, çmimi i shitjes për çantë është €482.00.

Për shkak të kufizimeve të qarkullimit të shkaktuar nga pandemia COVID-19, dërgesa e radhës (sipas porosive të planifikuara) e lëkurës është anuluar dhe kompania 'LUX' ka në dispozicion vetëm 500m² të lëkurës në stoqe.

Kërkohet:

- a. Llogaritni numrin e rripave që kompania 'LUX' duhet të shesë për të arritur pikën e rentabilitetit. ***3 pikë***
- b. Llogaritni kontributin që do të gjenerojë kompania 'LUX' në situatën kur:
 - i. përmbushë kërkesën për çanta dore të kontraktuara për 'Javën e modës', ***4 pikë***
 - ii. zhvillon planin e prodhimit të cili maksimizon kontributin duke mos pasur kufizim të kërkesës për asnjërin prej dy produkteve. ***6 pikë***
- c. Llogaritni numrin e njërive të rripave dhe çantave që kompania 'LUX' duhet të shesë për të arritur pikën e rentabilitetit duke supozuar se përzierja konstante e shitjeve i përgjigjet shitjeve sipas planit të prodhimit nën pikën (b.i). ***5 pikë***
- d. Llogaritni maksimumin e vlerës së gjobës financiare të cilën kompania 'LUX' është e gatshme të paguaj për mos-dorëzimin/prodhimin e çantave, respektivisht nëse lëkurën e nevojshme për prodhimin e çantave do të shfrytëzonte për prodhimin e rripave. ***2 pikë***

Zgjidhja e problemit 1

a. Llogaritja e numrit të njësive (rripave) për pikën e rentabilitetit (PR)

Formulat: Njësi për PR = Kosto (totale) fikse ÷ Kontributi për njësi

Kontributi për njësi = Çmimi i shitjes për njësi - Kosto variabile për njësi

Kosto variabile për njësi = MD për njësi + PD për njësi + ShPP variabile për njësi

$$\begin{aligned} \text{Kosto variabile për njësi} &= (\text{€}80.0 \times 0.2 \text{ m}^2) + (\text{€}24.0 \times 1.0 \text{ orë}) + \text{€}6.0 \\ &= \text{€}16.0 + \text{€}24.0 + \text{€}6.0 \\ &= \text{€}46.0 \text{ për njësi} \end{aligned}$$

1 pikë

$$\begin{aligned} \text{Kontributi për njësi} &= \text{€}96.0 - \text{€}46.0 \\ &= \text{€}50.0 \text{ për njësi} \end{aligned}$$

1 pikë

$$\begin{aligned} \text{Njësi për PR} &= \text{€}40,000 \div \text{€}50 \\ &= \underline{\underline{800 \text{ njësi}}} \end{aligned}$$

1 pikë

b. Llogaritja e kontributit ...

i. ... kur përmbushët kërkesa për çanta dore të kontraktuara

- Zhvillimi i planit të prodhimitarisë:

MD (lëkura) në dispozicion (m²) 500

Përdorimi i lëkurës për prodhimin e çantave (250 njësi × 1.5m²) 375

Lëkura në dispozicion për prodhimin e rripave (m²) 125

Rripat për t'u prodhuar (125m² ÷ 0.2m²) (njësi) 625

2 pikë

- Kontributi për planin e zhvilluar të prodhimitarisë:

$$\begin{aligned} \text{Kontributi për njësi për çantë të dorës} &= \text{€}482 - [(\text{€}80 \times 1.5\text{m}^2) + (\text{€}24 \times 2 \text{ orë}) + \text{€}20] \\ &= \text{€}482 - (\text{€}120 + \text{€}48 + \text{€}20) \\ &= \text{€}482 - \text{€}188 \\ &= \text{€}294 \text{ për njësi} \end{aligned}$$

1 pikë

Kontributi total për çanta të dorës = 250 njësi × €294 = €73,500

Kontributi total për rripa = 625 njësi × €50 = €31,250

Kontributi i përgjithshëm €104,750

1 pikë

ii. ... maksimal duke mos pasur kufizim të kërkesës për asnjë produkt

- Zhvillimi i planit të prodhimitarisë (bazuar në faktorin kufizues) - llogaritja e kontributit për njësi të faktorit kufizues dhe përcaktimi i renditjes së produkteve:

	<u>Rripi</u>	<u>Çanta e dorës</u>
Çmimi i shitjes për njësi	96	482
Kosto variabile për njësi	<u>46</u>	<u>188</u>
Kontributi për njësi	50	294
Përdorimi i kufizimit për njësi (m ²)	0.2	1.5
Kontributi për njësi të faktorit kufizues	250	196
Renditja (sipas Kontributit për njësi të FK më të lartë)	1	2

2+2 = 4 pikë

Bazuar në kontributit për njësi të faktorit kufizues dhe renditjes së përcaktuar më lartë në rastin kur nuk ka kufizim të kërkesës maksimizimi i kontributit arrihet kur prodhohet produkti i parë sipas renditjes - rripi në shfrytëzimin maksimal të kufizimit - lëkurës. Nga kjo rrjedh se e gjithë sasia e lëkurës - 500m² duhet të përdorën për prodhimin e rripave.

- Llogaritja e kontributit maksimal

Numri maksimal i rripave që mund të prodhohen

MD (lëkura) në dispozicion (m ²)	500
Përdorimi i lëkurës për prodhimin e një njësie (rripi) (m ²)	<u>0.2</u>
Numri i rripave për t'u prodhuar (njësi)	2,500

Vlera e kontributit maksimal = Numri i njësive × kontributi për njësi
 = 2,500 njësi × €50
 = **€125,000**

1 + 1 = 2 pikë

c. Llogaritja e numrit të njësive (përzierjes së rripave dhe çantave) për pikën e rentabilitetit (PR)

	<u>Rripi</u>	<u>Çanta e dorës</u>
Numri i njësive (plani i prodhimit pika b.i.)	625	250
prej nga rrjedh*		
Raporti i përzierjes së shitjeve	5	2
Kontributi për njësi	<u>€50</u>	<u>€294</u>
Kontributi i njësive totale të produkteve në përzierje	€250	€588
Kontributi i përgjithshëm i përzierjes (€250 + €588)	€838	2 pikë

* nëse dy vlerat i pjesëtojmë me numrin e përbashkët të plotpjesëtueshëm **125**

Formula: Përzierje për PR = Kosto (totale) fikse ÷ Kontributi i përzierjes
 = €40,000 ÷ €838
 = 47.7327 = **48 përzierje** (e rrumbullakuar)

1 pikë

Numri i rripave = 48 përzierje × 5 njësi në përzierje = 240 rripa

Numri i çantave = 48 përzierje × 2 njësi në përzierje = 96 çanta

2 pikë

d. Llogaritja e maksimumit të vlerës së gjobës financiare

Vlera e kontributit maksimal (nëse prodhohen vetëm rripat)	€125,000
Vlera e kontributit kur përmbushët kërkesa për çanta të kontraktuara	<u>€104,750</u>
Vlera maksimale e gjobës financiare	€20,250

2 pikë

Problemi 2

- a. Kompania 'Fshesa' prodhon dhe shet fshesa elektrike për nevoja shtëpiake. Të dhënat në vazhdim i përkasin njërive të prodhuara dhe shitura të modelit 'Delux' për 4 periudhat e fundit tremujore:

	<u>Periudha 1</u>	<u>Periudha 2</u>	<u>Periudha 3</u>	<u>Periudha 4</u>
	<u>njësi</u>	<u>njësi</u>	<u>njësi</u>	<u>njësi</u>
Shitjet	2,500	2,300	2,450	2,400
Prodhimit	2,500	2,500	2,250	2,500

Të dhënat tjera që lidhen me këtë model janë si më poshtë:

- Çmimi i shitjes për njësi €100.00
- Kosto variabile e prodhimit për njësi €54.00
- Kosto e përgjithshme fikse e prodhimit për tremujor €65,000
- Aktiviteti normal i kompanisë për tremujor, mbi të cilin bazohet buxheti është 2,500 njësi, ndërsa kompania nuk kishte stoqe përfundimtare para periudhës 1 (në periudhën 0).

Pasqyra e operacioneve sipas kostos marginale

	<u>Periudha 1</u>	<u>Periudha 2</u>	<u>Periudha 3</u>	<u>Periudha 4</u>
Shitjet	250,000	230,000	245,000	240,000
KV të prodhimit	135,000	135,000	121,500	135,000
+ stoqet fillestare	0	0	10,800	0
- Stoqet përfundimtare	(0)	(10,800)	(0)	(5,400)
Kostot variabile të shitjes	<u>135,000</u>	<u>124,200</u>	<u>132,300</u>	<u>129,600</u>
Kontributi	115,000	105,800	112,700	110,400
Kostoja fikse	<u>65,000</u>	<u>65,000</u>	<u>65,000</u>	<u>65,000</u>
Fitimi i periudhës	50,000	40,800	47,700	45,400

Kërkohet:

- i. Të përgatitet pasqyra e operacioneve për secilën periudhë bazuar në sistemin e kostos përvetësuese **5 pikë**
 - ii. Të përgatitet tabela e cila do të tregojë diferencat e fitimeve të secilës periudhë dhe fitimit total në mes të sistemit të kostos marginale dhe sistemit të kostos përvetësuese. Shkurtimeisht komentoni rezultatet e arritura në secilën periudhë dhe në total. **5 pikë**
- b. Kompania 'Fshesa' shqyrton mundësinë për zhvillimin e produktit të ri, fshesës 'Delux plus' për përdorim në objekte administrative dhe hoteliere. Nga hulumtimet e bëra janë grumbulluar të dhënat në vazhdim:
- Çmimi i tregut për produkte të ngjashme është €230 për njësi, ndërsa kompania aplikon marzhën e fitimit prej 25%.
 - Motori i fshesës ka kosto prej €95 për copë, ndërsa transporti i motorëve bëhet në grupe nga 50 copë me kosto prej €200 për grup.
 - Për secilën fshesë nevojiten 8 metra të kabllor elektrike. Kablloja elektrike blihet e mbështjellë në bobina dhe është vlerësuar se nga sasia e kabllor së blerë 25% mbetet mbeturinë e procesit të prodhimit. Çmimi i blerjes për kablo është €1.50 për metër.
 - Materialet tjera të nevojshme (shtëpiza e fshesës, thesi i mbeturinave, komandat e përdorimit etj.) të gjitha së bashku kanë kostot të përbashkët prej €16 fshesë.
 - Për montimin e fshesës është formuar grupi prej 8 punëtorëve të cilët punojnë 8 orë në ditë, 5 ditë javë, 4 javë në muaj. Koha për montimin e një fshese është 2 orë, ndërsa norma e punës është €10 për orë.

- Si rezultat i hulumtimeve rrjedh se kërkesa mujore për fshesat 'Delux Plus' sillet prej 500 deri në 600 njësi në muaj, dhe kontabilisti menaxherial i kompanisë ka vlerësuar se ShPP varësisht nga niveli i kërkesës arrin vlerën nga €14,400 deri në €16,000 në muaj.

Kërkohet

- Të llogaritet kostoja e synuar dhe e vlerësuar për njësi për fshesën 'Delux Plus'. **6 pikë**
- Të shpjegohet çfarë është hendeku i kostos. Nëse në llogaritjet nga pika (b.i.) një hendek i tillë ekziston mbështetni shpjegimet duke u bazuar në atë rezultat. **2 pikë**
- Shpjegoni dallimin në mes të kostos standarde dhe kostos së synuar. **2 pikë**

Zgjidhja e problemit 2

a. Pasqyra e operacioneve ...

- ... për secilën periudhë bazuar në sistemin e kostos përvetësuese

Formula: Norma e përvetësimit (NP) = ShPP e vlerësuar ÷ niveli i vlerësuar i aktivitetit

ku

ShPP e vlerësuar = Koston fikse për tremujor = €65,000

Niveli i vlerësuar (buxhetuar) i aktivitetit për tremujor = 2,500 njësi

Rrjedh

Norma e përvetësimit (NP) = €65,000 ÷ 2,500 njësi
= **€26 për njësi**

		<u>Periudha 1</u>	<u>Periudha 2</u>	<u>Periudha 3</u>	<u>Periudha 4</u>
Shitjet	€100 × numri i njësive	250,000	230,000	245,000	240,000
<i>Kostot e prodhimitarisë (KP):</i>					
<i>variabile</i>	€54 × numri i njësive	135,000	135,000	121,500	135,000
<i>fikse</i>	€26 × numri i njësive	65,000	65,000	58,500	65,000
		200,000	200,000	180,000	200,000
+ stoqet fillestare (SF)	KP × njësi në SF	0	0	**16,000	0
- stoqet përfundimtare (SP)	KP × njësi në SP	0	*16,000	0	***8,000
Kosto prodhuese e shitjeve		200,000	184,000	196,000	192,000
nën- (mbi-) përvetësimi i ShPP		0	0	6,500	0
Kosto totale e prodhimitarisë		200,000	184,000	202,500	192,000
Fitimi për periudhën		50,000	46,000	42,500	48,000

* Stoqet përfundimtare = (€54 KV + €26 KF) × (2,500 njësi - 2,300 njësi) = €80 × 200 njësi = €16,000

** Stoqet përfundimtare të periudhës 2 (paraprake) = Stoqet fillestare të periudhës 3 (pasuese)

*** Stoqet përfundimtare = (€54 KV + €26 KF) × (2,500 njësi - 2,400 njësi) = €80 × 100 njësi = €8,000 **5 pikë**

- Tabela e diferencave të fitimeve të sistemit të kostos margjinale dhe sistemit të kostos përvetësuese

	<u>Periudha 1</u>	<u>Periudha 2</u>	<u>Periudha 3</u>	<u>Periudha 4</u>	<u>Total</u>
Fitimi sipas kostos margjinale	50,000.0	40,800.0	47,700.0	45,400.0	183,900.0
Fitimi sipas kostos përvetësuese	50,000.0	46,000.0	42,500.0	48,000.0	186,500.0
Diferenca	0.0	5,200.0	-5,200.0	2,600.0	2,600.0

Periudha 1

Fitimet sipas parimeve të kostos margjinale dhe fitimet sipas parimeve të kostos përvetësuese janë të njëjta për periudhën 1. Kjo është për shkak se nuk ka asnjë ndryshim në nivelet e stoqeve gjatë kësaj periudhe.

Periudha 2

Fitimet sipas parimeve të kostos përvetësuese janë për €5,200 më të larta se fitimet sipas parimeve të kostos margjinale. Nivelet e stoqeve përfundimtare janë rritur për 200 njësi gjatë kësaj periudhe, të cilat përfshijnë ShPP fikse të përvetësuar në vlerë prej €5,200 (200 njësi × €26 për njësi).

Periudha 3

Gjatë kësaj periudhe, niveli i në mes të njërive të shituar dhe njërive të prodhuara kanë rënie për 200 njësi. Kur nivelet e stoqeve shënojnë rënie gjatë një periudhë, fitimet sipas kostot përveçësuese janë më të ulëta se fitimet sipas kostos marginale për €5,200 (200 njësi × €26 për njësi).

Periudha 4

Ndryshimi në fitim gjatë kësaj periudhe = ndryshimi në nivelet e stoqeve × ShP fikse të përveçësuar për njësi

$$\begin{aligned} &= (\text{Stoqet fillestare} + \text{njësitë e prodhuara} - \text{njësitë e shitura}) \times \text{€26} \\ &= (0 + 2,500 - 2,400) \times \text{€26} \\ &= 100 \times \text{€26} \\ &= \text{€2,600} \end{aligned}$$

Pasi që stoqet fillestare janë zero, dhe stoqet përfundimtare janë 100 njësi (0 + 2,500 - 2,400), rrjedh se nivelet e stoqeve janë rritur për 100 njësi. Parimet e kostos përveçësuese raportojnë fitime më të larta krahasuar me parimet e kostos marginale kur nivelet e stoqeve rriten gjatë një periudhe, fitimet sipas kostos përveçësuese janë për €2,600 më të mëdha se fitimet sipas kostos marginale gjatë kësaj periudhe.

Totali

Fitimi i përgjithshëm sipas kostos përveçësuese është për €2,600 më i madh se fitimi i përgjithshëm sipas kostos marginale për periudhat 1-4. Kjo është për shkak se në fillim të periudhës 1, stoqet fillestare ishin zero, dhe në fund të periudhës 4, stoqet përfundimtare ishin 100 njësi. Më pas, arsyetimi është i njëjtë si për periudhë 4 më sipër. 5 pikë

b. Llogaritja e kostos së synuar ...

i. ...për njësi për fshesën 'Delux Plus'

Formula: Kosto e synuar = Çmimi i synuar i shitjes - Fitimi i synuar

Çmimi i shitjes	100%		€230.00	
Marzha e fitimit	25%	(€230 × 25%)	<u>€57.50</u>	0.5 pikë
Kostot e synuar			€172.50	0.5 pikë

- Llogaritja e kostot së vlerësuar

Kosto e materialeve				
Motori			€95	
Motori (transporti)		(€200 ÷ 50 copë)	€4	0.5 pikë
Kabloja elektrike (përdorimi)		(8 metra × €1.5)	€12	0.5 pikë
Kabloja elektrike (mbeturina)		(2.67* metra × €1.5)	€4	1 pikë
Materialet tjera			€16	
Kosto e punës				
Puna e drejtpërdrejt		(2 orë × €10)	€20	0.5 pikë
ShPP (e zbërthyer sipas metodës 'e lartë - e ultë')**				
ShPP variable**		(2 orë × €8)	€16	0.5 pikë
ShPP fikse***		(2 orë × €5)	<u>€10</u>	1.5 pikë
Kosto e vlerësuar			€177	0.5 pikë

* Nëse ...

Sasia e kabllot elektrike së blerë	=	100%
Mbeturina (Y metra)	=	<u>25%</u>
Sasia e kabllot së përdorur (8 metra)	=	75%

atëherë formohet proporcioni (i drejtë):

$$8 \text{ m} : 75 = Y : 25$$

Shumëzohet elementet e jashtme mes veti dhe elementet e brendshme mes veti $75Y = 200$

nga rrjedh se gjatësia e mbeturinës së kabllot elektrike është $Y = 200 \div 75$

2.67 metra

** Përdorimi i metodës 'e lartë-e ultë' për ndarjen e pjesës së kostos variabile dhe pjesës së kostos fikse në rastet kur kemi ShPP e përgjithshme. Kushti për përdorimin e kësaj metode është i plotësuar sepse janë të dhëna kostot e përgjithshme (në €) dhe nivelet e aktiviteteve (njësitë) për dy nivele të kërkesës mujore.

	<u>ShPP (€)</u>	<u>Niveli i aktiviteteve (orë)</u>
Niveli i lartë	€16,000	(600 njësi × 2 orë) 1,200
Niveli i ultë	<u>€14,400</u>	(500 njësi × 2 orë) <u>1,000</u>
	€1,600	200

$$\begin{aligned} \text{Kosto variabile për orë} &= \text{Ndryshimi në ShPP} \div \text{Ndryshimi në njësi (orë)} \\ &= €1,600 \div 200 \text{ orë} \\ &= \mathbf{€8 \text{ për orë}} \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} \text{Kosto variabile për njësi} &= \text{Kosto variabile për orë} \times \text{Orët e nevojshme për njësi} \\ &= €8 \times 2 \text{ orë} \\ &= \mathbf{€16} \end{aligned}$$

*** Llogaritja e kostos fikse (KF) për njësi

$$\text{Funksioni i kostos totale (KT): } KT = KF + (KV \text{ për njësi} \times \text{numri i njësive})$$

Zëvendësojmë vlerat e njohura të KT, KV për njësi dhe numrin e njësive (orëve) në funksionin e KT të nivelit të lartë (ose të nivelit të ulët)

$$\begin{aligned} €16,000 &= KF + (€8 \times 1,200 \text{ orë}) \\ KF \text{ (mujore)} &= €16,000 - €9,600 \\ \mathbf{KF \text{ (mujore)} &= €6,400} \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} \text{Niveli mujor e aktivitetit (orëve të punës)} &= \text{Orët në ditë} \times \text{Ditë në javë} \times \text{Javë në muaj} \times \text{numri i punëtorëve} \\ &= 8 \text{ orë} \times 5 \text{ ditë} \times 4 \text{ javë} \times 8 \text{ punëtor} \\ &= \mathbf{1,280 \text{ orë pune}} \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} \text{Kosto fikse për orë} &= \text{Kosto mujore fikse} \div \text{Niveli mujor e aktivitetit (orëve të punës)} \\ &= €64,000 \div 1,280 \text{ orë} \\ &= \mathbf{€5 \text{ për orë}} \end{aligned}$$

$$\begin{aligned} \text{Kosto fikse për njësi} &= \text{Kosto fikse për orë} \times \text{Orët e nevojshme për njësi} \\ &= €5 \times 2 \text{ orë} \\ &= \mathbf{€10} \end{aligned}$$

ii. Përkufizimi dhe llogaritja e hendekut të kostos

Hendeku (mospërputhja) e kostos së synuar është ndryshimi në mes të kostos së vlerësuar dhe kostos së synuar

$$\begin{aligned} \text{Formula: Hendeku i kostos} &= \text{Kosto e vlerësuar} - \text{kosto e synuar} \\ &= €177.00 - €172.50 \\ &= \mathbf{€4.50} \end{aligned}$$

1+ 1 = 2 pikë

iii. Dallimi në mes të kostos standarde dhe kostos së synuar

Dallimi në mes të këtyre dy kostove qëndron në atë se *kostoja e synuar* përfshinë vendosjen e një kostoje që duhet ta arrijë një produkt, që e ka të identifikuar një çmim të synuar të shitjes dhe një marzhë të kërkuar të fitimit

ndërsa,

kostoja standarde është një kosto e vlerësuar për njësi e ndërtuar sipas standardeve të secilit element të kostos (çmimit standard të burimeve dhe përdorimit standard të burimeve).

1+ 1 = 2 pikë

Problemi 3

Kompania 'Plus' prodhon dhe shet një produkt të vetëm, Produktin Plus. Kompania operon në një treg ku ka konkurrencë jo të përsosur, kështu që për të shitur më shumë njësi të Produktit Plus, ajo duhet të ulë çmimin e shitjes e të gjitha njësive që ajo shet. Informacioni i mëposhtëm tregon për lëvizjet e çmimeve dhe kostove me rritjen e numrit të njësive që kompania i plasoi në treg.

<u>Numri total i njësive</u>	<u>Çmimi i shitjes për njësi</u>	<u>Kosto mesatare</u>
0	0	0
1	343	564
2	320	350
3	299	274
4	277	226
5	256	185
6	235	164
7	216	155
8	197	153
9	186	157
10	179	164

Kostoja totale për zero output është €380.

Kërkohet

- a. Plotësoni tabelën më poshtë për të përcaktuar nivelin e output-it dhe të çmimeve në të cilën organizata do të maksimizon fitimet e saj, duke supozuar se ndarjet e njësive nuk mund të bëhet. Tregoni se cili është niveli i output-it (numri i njësive) i cili maksimizon fitimet dhe pse? **12 pikë**

<u>Njësiti</u>	<u>Çmimi për njësi</u>	<u>Të hyrat totale</u>	<u>Të hyrat marginale</u>	<u>Kostot mesatare</u>	<u>Kostot totale</u>	<u>Kostot marginale</u>	<u>Fitimi</u>
0							
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							

- b. Çfarë është çmimi shkulës (vjelës) i tregut dhe cili është qëllimi i caktimit të këtij çmimi nga pikëpamja e menaxhmentit të kompanisë? Në cilat raste është e përshtatshme të përdoret politika e çmimit shkulës (vjelës), listoni së paku dy prej tyre? **4 pikë**
- c. Çfarë është çmimi depërtues i tregut dhe cili është qëllimi i caktimit të këtij çmimi nga pikëpamja e menaxhmentit të kompanisë. Në cilat raste është e përshtatshme të përdoret politika e çmimit depërtues, listoni së paku dy prej tyre? **4 pikë**

Zgjidhja e problemit 3

a. Niveli i output-it dhe çmimi për maksimizimin e fitimit

<u>Njësitë</u>	<u>Çmimi për njësi</u>	<u>Të hyrat totale</u>	<u>Të hyrat marginale</u>	<u>Kostot mesatare</u>	<u>Kostot totale</u>	<u>Kostot marginale</u>	<u>Fitimi</u>
<u>a</u>	<u>b</u>	<u>c = a × b</u>	<u>d</u>	<u>e</u>	<u>f = a × e</u>	<u>g</u>	<u>h = d - f</u>
0	0	0	0	0	380	0	-380
1	343	343	343	564	564	184	-221
2	320	640	297	350	700	136	-60
3	299	897	257	274	822	122	75
4	277	1,108	211	226	904	82	204
5	256	1,280	172	185	925	21	355
6	235	1,410	130	164	984	59	426
7	216	1,512	102	155	1,085	101	427
8	197	1,576	64	153	1,224	139	352
9	186	1,674	98	157	1,413	189	261
10	179	1,790	116	164	1,640	227	150

10 pikë

Niveli i output-it (numri i njësisve) i cili maksimizon fitimet është 7 njësi, me çmimin e shitjes prej €216 dhe fitimin e gjeneruar në vlerë prej €427.

Fitimi maksimizohet kur e Hyra Marginale është e barabartë me Koston Marginale (MR = MC). Në nivelin prej 7 njësisve të output-it e hyra marginale MR = 102 është më së afërmi (gati e barabartë) me koston marginale përkatëse MC = 101 dhe njëherit paraqet ndryshimin më të vogël të këtyre dy komponentëve krahasuar me ndryshimet të niveleve të output-eve tjera.

2 pikë

b. Çmimi shkulës (vjelës) i tregut

Çmimi shkulës (vjelës) përfshin caktimin e çmimeve të larta kur një produkt i ri paraqitet për herë të parë në treg, me qëllim të maksimizimit të fitimit në afat të shkurtër.

1 pikë

Qëllimi i vjeljes së tregut është që të krijohen fitime të larta për njësi në fillim të jetës së produktit, me shpresën që të ri-kthehen shpejt kostot e investimit.

1 pikë

Politika e çmimit shkulës (vjelës) mundet me qenë e përshtatshme në rastet e paraqitura më poshtë:

- Produkti është i ri dhe i ndryshëm, ashtu që konsumatorët janë të gatshëm të paguajnë çmime të larta në mënyrë që të jenë në përparësi ndaj njerëzve të tjerë që nuk e posedojnë atë.
- Fuqia e kërkesës dhe ndryshimi i kërkesës ndaj çmimit janë të panjohura. Është më mirë nga pikëpamja e marketingut që të fillohet duke vënë çmime të larta dhe pastaj t'i zvogëlojnë ato në qoftë se kërkesa për produktin rezulton të jetë me çmim elastik.
- Çmimet e larta në fazat e hershme të jetës së një produkti mund të gjenerojë rrjedhje të larta fillestare të parasë së gatshme. Për këtë arsye firma me probleme të likuiditetit mund të preferojnë vjeljen e tregut.
- Firma mund të identifikojë segmente të ndryshme të tregut për produktin, secili i gatshëm të paguaj çmime më të ulëta në mënyrë progresive. Prandaj, mund të jetë e mundur të vazhdojnë të shesin me çmime më të larta për disa segmente të tregut, derisa çmimet më të ulëta ju vihen në të tjerët.
- Produktet mund të kanë cikël të shkurtër të jetës, dhe kështu duhet të mbulojnë kostot e tyre të zhvillimit dhe të gjenerojnë fitim relativisht shpejt.

Maksimum $2 \times 1 = 2$ pikë

c. Çmimi depërtues i tregut

Caktimi i çmimit depërtues është një politikë e çmimeve të ulëta kur një produkt paraqitet për herë të parë në treg.

1 pikë

Qëllimi i caktimit të çmimit depërtues është që produkti të marrë kërkesë të fortë sa më shpejt pasi të jetë paraqitur në treg meqë çmimet e ulëta mund të nxisin kërkesë më të madhe.

1 pikë

Politika e një çmimi depërtues mund të jetë e përshtatshme në rastet e paraqitura më poshtë.

- Firma dëshiron të dekurajojë hyrësit e rinj në treg.
- Firma dëshiron të shkurtojë periudhën fillestare të ciklit jetësor të produktit, në mënyrë që të hyjnë në fazat e rritjes dhe maturimit sa më shpejt të jetë e mundur.
- Ekzistojnë ekonomi të shkallës të rëndësishme që do të arrihen nga vëllimi i lartë i output-it.
- Kërkesa është shumë elastike dhe kështu do të përgjigjet mirë ndaj çmimeve të ulëta.

Maksimum 2 × 1 = 2 pikë

Problemi 4

Kompania Omega prodhon Produktin Alfa dhe Produktin Beta, planifikimi i të cilave zhvillohet bazuar në koston standarde sipas një procesi të standardizuar. Në vazhdim janë të dhënat e planifikuara për muajin nëntor dhe ndryshimet e ndodhura gjatë muajit.

Çmimi standard i shitjes së Produktit Alfa është €80.00 për njësi, ndërsa për prodhimin e tij përdorën 2.0 kg të materialit X me një kosto standarde prej €6.00 kg. Rritja e çmimit të naftës në tregun botëror në mënyrë zinxhirë ka shkaktuar lëvizje të përgjithshme të çmimeve, andaj edhe çmimi i materialit X gjithashtu ka pësuar ndryshime dhe në qoftë se kompania Omega do të kishte bërë blerjen në mënyrë efikase, kostoja do të ishte €7.50 për kg. Çdo njësi e Produktit Alfa kërkon 4.0 orë të punës së drejtpërdrejtë. Gjatë nëntorit janë planifikuar të prodhohen 4,000 njësi të Produktit Alfa.

Produkti Beta shitet me çmimin standard prej €250 për njësi. Ky produkt përdorë materialin Z, dhe për prodhimin e një njësie të nevojiten 0.75 ton të materialit Z. Karakteristikë për këtë material është se çmimi i tij mund të ndryshojë shpejt. Ishte menduar që materiali Z do të kushtojë €45.0 për ton, por në fakt ata kanë paguar vetëm €42.0 për ton dhe në qoftë se ata do t'i kishin bërë blerjet si duhet kostoja do të kishte qenë edhe më e ultë, siç ishte në dispozicion të shitjes së lirë për vetëm €40.0 për ton. Për të prodhuar një njësi e Produktit Beta nevojiten 3 orë të punës së drejtpërdrejtë. Gjatë nëntorit janë planifikuar të prodhohen 1,000 njësi të Produktit Beta.

Norma e punës ë drejtpërdrejt është €12.0 në orë. Në fillim të nëntorit, pas planifikimeve të bëra, menaxhmenti ka negociuar një paketë të sigurisë të punës me punonjësit në këmbim me premtimin për rritjen e efikasitetit prej 5% që nënkupton, se punëtorët do të prodhojnë numrin e planifikuar të njërive të Produktit Alfa dhe Produktit Beta për kohë më të shkurtër se kohëzgjatja e planifikuar.

ShPP fikse është planifikuar në vlerën prej €24,000 ndërsa ShPP variabile në vlerën prej €3.0 për orë të punës.

Kërkohe

- a. Përgatitni buxhetit fillestar dhe një buxhet të ri-shikuar duke bërë lejitmet për faktorët e kontrollueshëm në një format të përshtatshëm. Llogaritni mospërputhjen e përgjithshme të fitimit standard dhe fitimit të rishikuar dhe nëse ekziston tregoni a është mospërputhje e favorshme apo e pafavorshme. **12 pikë**
- b. Çfarë janë mospërputhjet e planifikimit, cilat janë dhe e kujt është përgjegjësia për mospërputhjet e planifikimit. **4 pikë**
- c. Çfarë janë mospërputhjet e operacioneve, cilat janë dhe e kujt është përgjegjësia për mospërputhjet e operacioneve. **4 pikë**

Zgjidhja e problemit 4

a. Buxheti fillestar, buxheti i ri-shikuar dhe mospërputhja e fitimit standard dhe të ri-shikuar

<u>Buxheti fillestar</u>	<u>Produkti Alfa</u>		<u>Produkti Beta</u>		<u>Totali</u>
Të hyrat nga shitjet	$(4,000 \times 80)$	320,000	$(1,000 \times 250)$	250,000	570,000
Kostot e prodhimitarisë:					
Materiali direkt X	$(4,000 \times 2 \times 6)$	48,000			48,000
Materiali direkt Z			$(1,000 \times 0.75 \times 45)$	33,750	33,750
Puna direkte	$(4,000 \times 4 \times 12)$	192,000	$(1,000 \times 3 \times 12)$	36,000	228,000
ShPP variabile	$(4,000 \times 4 \times 3)$	48,000	$(4,000 \times 3 \times 3)$	9,000	57,000
ShPP fikse					24,000
Fitimi standard					179,250

5 pikë

<u>Buxheti i ri-shikuar</u>	<u>Produkti Alfa</u>		<u>Produkti Beta</u>		<u>Totali</u>
Të hyrat nga shitjet	$(4,000 \times 80)$	320,000	$(1,000 \times 250)$	250,000	570,000
Kostot e prodhimitarisë:					
Materiali direkt X	$(4,000 \times 2 \times 7.5)$	60,000			60,000
Materiali direkt Z			$(1,000 \times 0.75 \times 40)$	30,000	30,000
Puna direkte $*(100\% - 5\%)$	$[4,000 \times (4 \times 0.95^*) \times 12]$	182,400	$[1,000 \times (3 \times 0.95^*) \times 12]$	34,200	216,600
ShPP variabile $*(100\% - 5\%)$	$[4,000 \times (4 \times 0.95^*) \times 3]$	45,600	$[1,000 \times (3 \times 0.95^*) \times 3]$	8,550	54,150
ShPP fikse					24,000
Fitimi i ri-shikuar					185,250

6 pikë

Mospërputhja e fitimit standard dhe të ri-shikuar

Fitimi standard	€179,250
Fitimi i ri-shikuar	<u>€185,250</u>
Mospërputhja e fitimit	€6,000 e favorshme

1 pikë

b. Mospërputhjet e planifikimit

Mospërputhjet e planifikimit janë mospërputhjet që janë shkaktuar nga ri-shikimi në buxhet apo kosto standarde, dhe llogariten duke krahasuar buxhetin fillestar/koston standarde me buxhetin e ri-shikuar apo koston standarde të ri-shikuar.

Përgjegjësia për mospërputhjet e planifikimit ju atribuohen menaxherëve (planifikuesve) të cilët përgatitën buxhetin apo koston standarde për 'gabimet' në buxhet apo kosto standarde. Mirëpo në shumë raste, ri-shikimet në një buxhet ose në kosto standarde janë për shkaqe jashtë kontrollit të planifikuesve. Në raste të tilla nuk mund të 'fajësohen' planifikuesit, p.sh. një rritje e papritur në çmimin e tregut për materialet, është përtej kontrollit të planifikuesve, apo për një kolaps të papritur në kërkesën e tregut për produktet e një industrie, duke rezultuar në një mospërputhje të pafavorshme në vëllimin e planifikuar të shitjes.

2 + 2 = 4 pikë

c. Mospërputhjet e operacioneve

Mospërputhjet e operacioneve janë mospërputhjet që janë shkaktuar nga dallimet në mes të performancës aktuale dhe buxhetit të ri-shikuar apo standardit, dhe llogariten në mënyrë të njëjtë si mospërputhjet 'normale' bazë, përveç se ato janë të bazuara në një krahasim në mes të rezultateve aktuale dhe të buxhetit/koston standarde të ri-shikuar.

Përgjegjësia për mospërputhjet e operacioneve duhet të gjurmohet të menaxherët të cilët janë në një pozitë të autoritetit dhe kontrollit mbi operacionet ku mospërputhjet ndodhin. Përgjegjësia e menaxherëve të operacioneve për mospërputhjet varet nga struktura organizative dhe ndarjes së autoritetit si dhe përgjegjësisë në mes të menaxhmentit, p.sh. një mospërputhje e çmimit të materialit është dallimi në mes kostove aktuale dhe standarde të blerjes së materialeve, menaxheri operacional përgjegjës për këtë mospërputhje duhet të jetë menaxheri i cili merr vendimet në lidhje me blerjen e materialeve. Ky mund të jetë kreu i blerjeve në një organizatë, dhe menaxheri i prodhimitarisë në një organizatë tjetër.

2 + 2 = 4 pikë

Problemi 5

Buxheti i kompanisë Omega për Produktin Gama për muajin dhjetor të këtij viti është paraqitur në vazhdim:

Vëllimi i buxhetuar i shitjeve	4,500 njësi
Të hyrat e buxhetuara nga shitjet	€142,200
Vëllimi i buxhetuar i prodhimit	4,500 njësi
Blerjet e buxhetuara të materialit direkt	3,000 kg.
Përdorimi i buxhetuar i materialit direkt	2,700 kg.
Kosto e buxhetuar e materialit direkt	€19,500
Orët e buxhetuara të punës direkte	6,750 orë
Kosto e buxhetuar e punës direkte	€54,000
Kosto e buxhetuar e ShPP-së variabile	€20,250
Kosto e buxhetuar e ShPP-së fikse	€17,550
Kostot e buxhetuar fikse jo e prodhimit	€9,000

Kërkohe

- Llogaritni vlerën e të gjithë përbërësve standard të kartelës së kostos standarde. **7 pikë**
- Ndërtoni kartelën e kostos standarde për Produktin Gama për muajin dhjetor bazuar në rezultatet nga pika (a.). **5 pikë**
- Llogaritni vlerën (në €) dhe koeficientin (në dy decimale) të kontributit standard, fitimit standard bruto dhe fitimit standard neto për Produktin Gama. **8 pikë**

Zgjidhja e problemit 5

a. Llogaritja e vlerës së përbërësve standard

- <i>Përbërësit standard të materialeve direkte (MD)</i>			
Çmimi standard	(kosto e buxhetuar) 19,500	(blerjet e buxhetuara) 3,000	€6.50 kg.
Përdorimi standard	(përdorimi i buxhetuar) 2,700	(prodhimi i buxhetuar #) 4,500	0.60 kg.
- <i>Përbërësit standard të punës direkte (PD)</i>			
Norma standarde	(kosto e buxhetuar) 54,000	(orët e buxhetuara të PD) 6,750	€8.00 ora
Efikasiteti standard	(orët e buxhetuara të PD) 6,750	(prodhimi i buxhetuar #) 4,500	1.5 orë
- <i>Përbërësit standard të ShPP variabile</i>			
Norma standarde	(kosto e buxhetuar) 20,250	(orët e buxhetuara të PD) 6,750	€3.00 ora
Efikasiteti standard	(orët e buxhetuara të PD) 6,750	(prodhimi i buxhetuar #) 4,500	1.5 orë
- <i>Përbërësit standard të ShPP fikse</i>			
ShPP fikse për njësi	(kosto e buxhetuar) 17,550	(prodhimi i buxhetuar #) 4,500	€3.9 për njësi 7 × 1 = 7 pikë

b. Kartela e kostos standarde

	<u>Njësi</u>	<u>Kosto (€)</u>	<u>Vlera</u>	
Materialet direkte	0.60	6.50	€3.90	1 pikë
Puna direkte	1.50	8.00	€12.00	1 pikë
ShPP variabile	1.50	3.00	€4.50	1 pikë
ShPP fikse		3.90	€3.90	1 pikë
			€24.30	1 pikë

c. Llogaritja e vlerës (në €) dhe koeficientit (në dy decimale) të ...

... kontributit standard

Çmimi standard i shitjes (të hyrat e buxhetuara) 142,200	(shitjet e buxhetuara #) 4,500	€31.60
Totali i kostos variabile	(MD) 3.9 + (PD) 12.0 + (ShPP v.) 4.5	<u>€20.40</u>
Kontributi		€11.20

Koeficienti i kontributit

$$\begin{aligned} \text{Formula: Koeficienti i kontributit} &= \text{Kontributi} \div \text{Shitjet} \\ &= €11.20 \div €31.60 \\ &= \mathbf{35.44\%} \end{aligned}$$

3 pikë

... fitimit standard bruto

Çmimi standard i shitjes (të hyrat e buxhetuara) 142,200	(shitjet e buxhetuara #) 4,500	€31.60
Totali i kostos së prodhimitarisë	(MD) 3.9 + (PD) 12.0 + (ShPP v.) 4.5 + (ShPP v.) 3.9	<u>€24.30</u>
Fitimi bruto		€7.30

Koeficienti i fitimit bruto

$$\begin{aligned} \text{Formula: Koeficienti i fitimit bruto} &= \text{Fitimi bruto} \div \text{Shitjet} \\ &= €7.30 \div €31.60 \\ &= \mathbf{23.10\%} \end{aligned}$$

2 pikë

... fitimit standard neto

Çmimi standard i shitjes (të hyrat e buxhetuara) 142,200	(shitjet e buxhetuara #) 4,500	€31.60
Totali i kostos së prodhimitarisë	(MD) 3.9 + (PD) 12.0 + (ShPP v.) 4.5 + (ShPP f.) 3.9	<u>€24.30</u>
Fitimi bruto		€7.30
Kostot periodike (KF të buxhet. jo të prodhimitarisë) 9,000	(prodhimi i buxhetuar #) 4,500	<u>€2.00</u>
Fitimi neto		€5.30

Koeficienti i fitimit neto

$$\begin{aligned} \text{Formula: Koeficienti i fitimit neto} &= \text{Fitimi neto} \div \text{Shitjet} \\ &= €5.30 \div €31.60 \\ &= \mathbf{16.77\%} \end{aligned}$$

3 pikë